



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **146**

Prishtinë, më 29.4.2014, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Ramiz Lladrovci, Nijazi Idrizi.

Mungoi : Boban Todorović dhe Faton Topalli.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 15.4.2014,
3. Raporti nga vizita në Prevallë rreth Peticionit të parashtruar,
4. Gjendja e projektligjeve në komision,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndonjë ndryshim.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.4.2014

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur me 15 prill 2014 me vërejtjen e **Sevdije Lamës** për të evidentuar edhe pyetjen e sajë që i ka bërë drejtorit të ZRRUK rreth kualitetit të ujit në qytetin e Pejës ku mungojnë listat e banorëve-konsumatorëve dhe zbatimit të vendimit për paushallë, në të cilin pyetje drejtori u përgjigj se kjo procedurë është në vazhdim e sipër, jo vetëm në Pejë por në tërë Kosovën, ngase me evidentimin

e konsumatorëve do të eliminohen problemet rreth pagesave sipas banorëve sa janë e jo paushallë, njëherit ai theksoi se ky problem është më i madh në Prishtinë. **Ramiz Lladrovci** potencoi se diskutimet më të hollësishme mund të kërkohen vetëm përmes transkriptit e jo në procesverbal, gjë që vërtetoi edhe **Afërdita Berisha**.

3. Raporti nga vizita në Prevallë rreth Peticionit të parashtruar

Kryetari Nait Hasani njoftoi komisionin përkatësisht anëtarët që nuk ishin në vizitë në Prevallë, se atje është konstatuar një gjendje diskutabile midis banorëve dhe inspektoratit të MMPH rreth ndërtimeve pa leje, sidomos te një rast ku paska pas një shtallë por pronari ka ndërtuar edhe dy objekte tjera. Rasim Demiri ishte prezent në vizitë, vazhdoi kryetari, por më vonë u largua me siguri për shkak të mosballafaqimit me gjendjen ekzistuese (**Rasim Demiri** reagoi dhe tha se nuk kishte kohë), megjithatë pasi që ka pasur dilema ftoi të pranishmit për diskutime. **Sevdije Lama** tha se kemi të bëjmë me rast të komplikuar dhe duhet të shikohet mundësinë për të sqaruar gjërat më tutje, për shkak se janë objekte ndihmëse që tregojnë se është dashur të ketë kujdes inspektorati. **Ramiz Lladrovci** potencoi faktin se Ligji sqaron mirë gjërat edhe poçes pas një rrënimi ndërtohet objekti i ri (duhet të kërkohet leja), gjithashtu leja duhet të kërkohet për themelet e vjetra jo për zgjerime të ndryshme. **Afërdita Berisha** theksoi se Komisioni veproi në bazë të sugjerimeve të Rasim Demirit për të dalur në këtë vend, por në anën tjetër MMPH duhet të ketë dokumentacionin komplet me ortofoto nëse dëshiron të veproi me rrënimë. Kryesuesi i task forcës, vazhdoi ajo, thoshte : nëse kanë vetëm një dokument (p.sh. faturat për pagesë të rrymës) ne nuk do të veprojmë.

Kryetari Nait Hasani sugjeroi për një rishshqyrtim të këtyre 5 rasteve nga MMPH, ndërsa komisioni nxori :

K O N K L U D I M

MMPH përkatësisht inspektorati të shqyrtoi edhe një herë rastet për rrënimë në Gornja Sellë të Prevallës për shkak të heqjes së dilemave rreth objekteve të ndërtuara.

4. Gjendja e projektligjeve në komision

Kryetari Nait Hasani sipas raportit me shkrim nga stafi i komisionit, njoftoi për gjendjen e deritanishme me projektligjet e proceduara në komision dhe konstatoi punën e suksesshme të këtij komisioni ngase vetëm një projektligj ka mbetur pa përfunduar për disa çështje të rëndësishme që duhet të kryhen lidhur me këtë projekt-informacioni mjedisor. Sa i përket projektligjit për zhurmën sugjeroi që të takohet komisioni të premtën, nëse përfundon e njëjta në komisionet e përhershme, për të konfirmuar për leximin e dytë.

Pasi që për pikën të ndryshme nuk kishte pika për shqyrtim, **Grupi punues për projektligjin e informacionit mjedisor** vazhdoi takimin e caktuar me zyrtarët e Agjencisë Kadastrale, mirëpo propozimet për shqyrtim (dëgjim publik, vizitë studimore etj) mbetën të vlerësohen javën e ardhshme kur saktësisht dihet çështja e punës së Kuvendit a vazhdon apo jo.

Mbledhja përfundoi në orën 12,10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani